



Prishtinë, 16 korrik 2015  
Kodi i ZRRE-së: V\_746\_2015

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-402-2012 dt. 15 qershor 2012 për lëshimin e Autorizimit final për shoqërinë "KelKos Energy" sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 17.6 MW, që përbëhet prej dy (2) njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: HC Belaja me kapacitet prej 9.2 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, në Komunën e Deçanit, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, të datës 13.07.2015 të shoqërisë "KelKos Energy" sh.p.k., me adresë: rruga "Sali Ceku", Ndërtesa Gogaj, nr. 14 – 51000, Komuna e Deçanit, Republika e Kosovës,

### në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "KelKos Energy" sh.p.k. dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, në lumin Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.



## Arsyetim

- ZRRE me datë 13.07.2015 nga shoqëria “**KelKos Energy**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, në lumin Lumëbardhi i Deçanit, komuna e Deçanit.
- Bordi i ZRRE-së me datë 15 qershor 2012, shoqërisë “**KelKos Energy**” sh.p.k., i ka lëshuar Vendimin V-402-2012 për Autorizimin final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


**IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-402-2012 dt. 15 qershor 2012 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën është lëshuar Autorizimi final shoqërisë “**KelKos Energy**” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.


**V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


**VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

### Bordi i ZRRE

  
Enver Halimi, kryesues

  
Merita Kostari, anëtare

  
Krenar Bujupi, anëtar



Prishtinë, 16 korrik 2015  
Kodi i ZRRE-së: V\_745\_2015

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit V-540-2013 dt. 28 qershor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej dy (2) njësie gjeneruese; HC Sharri me kapacitet prej 5.5 MW dhe HC Brezovica me kapacitet prej 3.6 MW në total prej 9.1 MW, në komunën e Shtërpçës, të datës 24.06.2015, të shoqërisë “Matkos Group” sh.p.k., me adresë rruga “Veternik”, p.n. KK Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_540\_2013 i datës 28 qershor 2013, për HC Sharri dhe HC Brezovica edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me **28 dhjetor 2015**.

## A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 29.03.2013 nga shoqëria “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, që përbëhet prej dy (2) njësie gjeneruese; HC Sharri me kapacitet prej 5.5 MW dhe HC Brezovica me kapacitet prej 3.6 MW në total prej 9.1 MW, në komunën e Shtërpçës.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, me datë 28 qershor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_540\_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “**Matkos Group**” sh.p.k., do t’i jepet Autorizimi për



ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.

- ZRRE me datë 24.06.2015 nga shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, ka pranuar Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, që përbëhet prej dy (2) njësive gjeneruese; HC Sharri me kapacitet prej 5.5 MW dhe HC Brezovica me kapacitet prej 3.6 MW në total prej 9.1 MW, në komunën e Shtërpcës, edhe për një afat shtesë sipas legjislacionit në fuqi.
  - Shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, ka sqaruar se: me datë 09.09.2014 nga MMPH kanë pranuar Vendimin për Pëlqim Mjedisor Nr. 14/3721/1-ZSP/182/14 për ndërtimin e HC-ve, në komunën e Shtërpcës. Po ashtu me datë 15.06.2015 nga MMPH kanë pranuar Kushtet Ujore për hartimin e dokumentacionit tekniko –Investiv nr. 5810/14 ZDP 692/15, me të cilën është aprovuar kërkesa e shoqërisë për kushtet ujore, lidhur me ndërtimin e HC-ve. Me datë 19.06.2015 në bazë të kushteve ujore është përpiluar dokumentacioni i kërkuar dhe ka aplikuar për Pëlqim Ujor.
  - Gjithashtu ka sqaruar se për shkak të procedurave të tej zgjatura të MMPH-së, nuk është mundur të sigurohet leja e ndërtimit dhe Pëlqimin Elektroenergjetik, pasi që pa sigurimin e Pëlqimit Ujor, këto leje nuk mund të sigurohen.
  - Andaj, bazuar në këtë që u tha më lartë, ka sqaruar se aplikuesi nuk ka pasur mundësi që në afatin e përcaktuar me pikën IV të diapozitivit të Vendimit V-540-2013 të datës 28 qershor 2013, të përmbush detyrimet e cekura dhe me dokumentacion të paraparë të aplikon për të lëshuar autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, dhe me këtë ka kërkuar zgjatjen e afatit për plotësimin e kërkesave ligjore që dalin nga neni 14 dhe 15 i Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesat e tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm për ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
  - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, dhe dokumentacionit të bashkangjitur, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Shoqëria **“Matkos Group” sh.p.k.**, duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji që përbëhet prej dy (2) njësive gjeneruese; HC Sharri me kapacitet prej 5.5 MW dhe HC Brezovica me kapacitet prej 3.6 MW në total prej 9.1 MW, në komunën e Shtërpcës, deri me datën **28 dhjetor 2015** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-540-2013 i datës 28 dhjetor 2013 mbi Njoftimi për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.




IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së**

  
\_\_\_\_\_

Enver Halimi, kryesues

  
\_\_\_\_\_

Merita Kostari, anëtare

  
\_\_\_\_\_

Krenar Bujupi, anëtar